

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SHA POGRADEC

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradeç, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.07.2009 deri me datë 31.08.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 175, datë 29.12.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 800/14, datë 29.12.2015, dërguar z. Valter Gora, Drejtor i Përgjithshëm në shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradeç, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

Gjetje nga auditimi

UK Pogradeç nuk i ka zbatuar në mënyrë të plotë rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH`së. Konkretisht:

-Në lidhje me rekomandimet për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, janë rekomanduar 9 masa organizative, nga të cilat janë realizuar 4 masa, realizuar pjesërisht 3 masa, ndërsa 2 masa nuk janë realizuar. Nga 4 masa për shpërblim dëmi, nga shoqëria UK Pogradeç nuk është realizuar asnjë, mos-ndjekja e rrugëve ligjore për arkëtimin e të cilave, i ka shkaktuar shoqërisë **dëm ekonomik në vlerën 49,424.4 EUR dhe 819,108.40 lekë.**

-Në lidhje me rekomandimet për Raportin Përfundimtar të Auditimit për Projektin “Mbrojtja e liqenit të Ohrit, Faza II Kanalizimet”, janë rekomanduar 2 masa organizative, nga të cilat 1 është realizuar, ndërsa 1 është realizuar pjesërisht. Nga 2 masa për shpërblim dëmi, nga shoqëria UK Pogradeç nuk është realizuar asnjë, mos-ndjekja e rrugëve ligjore për arkëtimin e të cilave, i ka shkaktuar shoqërisë **dëm ekonomik në vlerën 364,101.80 EUR dhe 430,986 DM (Trajtuar më hollësisht në faqet 16-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtohen vlerat **413,526.20 EUR, 819,108.40 lekë dhe 430,986 DM**, të cilat kanë të bëjnë me mos-zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e dëmeve të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, të merret vendimi përkatës dhe të dalë përgjegjësia për zhdëmtim. Vlerat **413,526.20 EUR, 819,108.40 lekë dhe 430,986 DM**, përbëjnë dëm ekonomik për shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA Pogradeç dhe buxhetin e shtetit.

Brenda datës 31.03.2016

2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Gjetje nga auditimi

-Nga Këshilli Mbikëqyrës nuk ka patur një angazhim serioz në analizimin e situatës për sa i përket treguesve ekonomikë e financiar të shoqërisë, si dhe nuk janë përgatitur plane konkrete veprimi dhe nuk janë përcaktuar objektiva të qarta për daljen nga situata, por është mjaftuar

vetëm me evidentimin e mangësive gjatë diskutimeve për përgatitjen e programeve ekonomiko-financiare. Nisur kjo edhe nga fakti që për periudhën Prill 2014 – Maj 2015, ka funksionuar me 4 anëtarë, nga 6 anëtarë të emëruar, për shkak të mungesave të vazhdueshme të 2 anëtarëve.

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, nuk kanë analizuar vlerën e lartë të debitorëve dhe kreditorëve, vlerë e cila rrezikon seriozisht performancën financiare të shoqërisë. Nga ana e tyre nuk janë marrë masa për uljen e këtyre detyrimeve, si dhe nuk janë nxjerrë përgjegjësitë konkrete për rritjen drastike të debitorëve për periudhën 2014-2015.

-Vendimet e Asamblesë së Aksionerëve nuk janë të noterizuara dhe nuk janë të firmosura nga Sekretari i Asamblesë në kundërshtim me nenin 14 të Statutit të shoqërisë, nuk janë të protokolluara, në kundërshtim me nenin 13 dhe nenin 18 të “Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nuk është marrë në konsideratë krijimi i një faqe WEB të shoqërisë për publikimin e këtyre vendimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, neni 143, pika 5.

-Në Statutin e shoqërisë parashikohet se anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të shkarkohen në rast të mungesës së tyre në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6 mujore, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 të Ministrit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës, “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime”, kreu II, pika 9, e cila përcakton se: “nëse një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi, atëherë Ministri i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës merr vendimin për lirimin e tij nga detyra” (Trajtuar më hollësisht në faqet 19-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, të merren masa për përshtatjen e statutit të shoqërisë me legjisllacionin në fuqi, lidhur me mungesat e anëtarëve në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës.

Brenda datës 31.03.2016

Nga sekretari i Asamblesë së Aksionerëve dhe Këshillit Mbikëqyrës, të merren masa për protokollimin dhe noterizimin e vendimeve dhe procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Aksionarit, si dhe të merren masa për krijimin e një faqe WEB të shoqërisë, ku të bëhet dhe publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë.

Brenda datës 31.03.2016 dhe Vazhdimisht

3. Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar.

Gjetje nga auditimi

-Programi ekonomiko-financiar i vitit 2015, nuk është i miratuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, në kundërshtim me Udhëzimin e MZHETTS nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, por vetëm nga Këshilli Mbikëqyrës.

-Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec ka raportuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime, më pak 359 mijë m³ sasinë e ujit të prodhuar, si dhe ka raportuar më pak 39 mijë m³ sasinë e ujit të shitur, si pasojë e raportimeve jo të sakta mujore.

-Konstatohet që humbjet për vitin 2010 janë në nivelin 48.3%, për vitin 2011 janë në nivelin 38.9%, për vitin 2012 janë në nivelin 29.7%, për vitin 2013 janë në nivelin 43.4%, për vitin 2014 në nivelin 53.3%, ndërsa për periudhën Janar - Gusht 2015 në nivelin 49.9% të ujit të prodhuar (Trajtuar më hollësisht në faqet 23-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të merret në analizë puna e departamenteve të shoqërisë me qëllim përmirësimin e treguesve të performancës financiare të shoqërisë, si dhe të merren masa që raportimet mbi realizimin e treguesve ekonomik e financiar, të jenë të plota, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, duke analizuar të dhënat historike mbi realizimin e treguesve tekniko ekonomik të shoqërisë, si dhe shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në mos arritjen e objektivave të shoqërisë, në zbatim të Udhëzimit të MZHETTS nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”. Çdo analizë dhe relacion të shoqërohet me evidentimin e mangësive, nxjerrjen e përgjegjësive, si dhe me një plan masash konkrete për arritjen e rezultateve.

Brenda datës 31.03.2016 dhe Vazhdimisht

4. Mbi zbatimin e dispozitat ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave e shpërblimeve.

Gjetje nga auditimi

-Nisur nga fakti që për shoqëritë deri në 100 punonjës, shkurtimi i më shumë se 10 punonjësve brenda 90 ditëve përbën pushim kolektiv, u konstatua se shoqëria gjatë muajit Nëntor 2013 ka ndërprerë marrëdhëniet e punës për 13 punonjës, duke mos ndjekur procedurat e **pushimit kolektiv**, si dhe me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 20.01.2014, janë shkurtuar 26 punonjës, në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 148.

-Nga lëvizja e punonjësve, si dhe mos-ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga çështjet gjyqësore në të cilat është paditur deri më datë 31.08.2015, shoqëria ka paguar vlerën **13,798,486 lekë** për 17 punonjës, vlerë e cila **përbën efekt financiar negativ** për llogari të shoqërisë Ujësjetës Kanalizime SHA Pogradec.

-Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve individuale për 21 punonjës të shoqërisë, u konstatua se në të gjitha rastet kishte mangësi në dokumentacionin e administruar në këto dosje, në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë datë 17.10.2006.

-Nga auditimi i dosjeve të punonjësve të shoqërisë, u konstatua se në shumë raste janë emëruar në punë të afërm të drejtuesve të shoqërisë në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesave. Konkretisht:

1. me detyrë specialiste e shërbimit konsumator për periudhën 01.07.2012 e në vazhdim, është e motra e me detyrë drejtor i departamentit teknik për periudhën 11.03.2014 e në vazhdim.
2. Me urdhrat e drejtorit të shoqërisë, më datë 22.10.2013, janë emëruar në detyrë 3 anëtarë të një familjeje: (babai) me detyrë operator i depozitës Guras, (i biri) dhe (i biri) të dy me detyrë specialist hidraulik për administrimin e prerjeve dhe mirëmbajtjes e setit të matësit.
3. me detyrë specialist mekanik për avaritë për periudhën 05.12.2013, është i biri i me detyrë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën Tetor 2011- Gusht 2015.

4. me detyrë specialist i leximit dhe kontrollit të matësit për periudhën 06.12.2013 e në vazhdim, është vëllai i me detyrë Menaxher i IT për periudhën objekt auditimi.
5. me detyrë specialist hidraulik i sistemit të ujit të pijshëm është i vëllai i me detyrë drejtor i departamentit të mirëmbajtjes.

-Nga Këshilli Mbikëqyrës nuk është marrë miratimi i Asamblesë së Aksionarëve për miratimin e niveleve të pagave, me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6.

-Nga tejkalmimi i numrit të punonjësve të miratuar në strukturë, është shkaktuar **efekt financiar negativ në vlerën 12,720,137 lekë**, për llogari të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu IV, pika 4.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 22.12.2011 “Për shpërblimin e fundvitit”, vendoset dhënia e shpërblimit në masën 10,000 lekë për punonjësit në kuadër të festave të fundvitit në vlerën 774,000 lekë, pa marrë miratimin e Asamblesë së Aksionarëve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6. Për pasojë **vlera 774,000 lekë përbën efekt financiar negativ** për llogari të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 20.12.2012 “Për miratimin e shpërblimit me rastin e festave të fundvitit”, vendoset dhënia e shpërblimit në masën e një page mujore për punonjësit në kuadër të festave të fundvitit në vlerën 2,440,572 lekë, pa marrë miratimin e Asamblesë së Aksionarëve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6. Për pasojë **vlera 2,440,572 lekë përbën efekt financiar negativ** për llogari të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 25-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe sektori i burimeve njerëzore, ti kushtohet vëmendje burimeve njerëzore, si faktor i rëndësishëm për kryerjen e një shërbimi cilësor për furnizimin me ujë të popullatës. Në këtë kontekst, të shikohet si përparësi vendosja e kriterëve në bazë të profesionalizimit në punësimin e stafit, si dhe plotësimi i dokumentacionit vërtetues për kualifikimet e tyre.

Brenda datës 31.03.2016 dhe Vazhdimisht

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, të marrin masa për ndjekjen e procedurave ligjore dhe miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve në Asamblenë e Aksionarit, referuar Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Brenda datës 31.03.2016

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, të marrin masa që për punësimin e punonjësve të rinj, tu japin përparësi atyre punonjësve që janë shkurtuar si pasojë e pushimit kolektiv, si edhe të marrin në analizë nevojat për punonjës dhe ndryshimet e shpeshta të numrit të fuqisë punëtore, referuar aktivitetit dhe mundësive financiare të shoqërisë.

Vazhdimisht

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë të rishqyrtojnë emërimin e punonjësve, duke zbatuar në emërimin e tyre Ligjin nr. 9637, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe të nxirren përgjegjësitë për efektin financiar negativ në vlerën **13,798,486 lekë**, të shkaktuar nga shkurtime të punonjësve duke mos ndjekur procedurat e duhura ligjore.

Brenda datës 31.03.2016 dhe Vazhdimisht

Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë tejkalimin e numrit mesatar të punonjësve krahasuar me strukturën e miratuar, në vlerën **12,720,137 lekë**, për periudhën Shtator 2011 - Tetor 2012 dhe Shkurt 2014 – Gusht 2015, të evidentohen përgjegjësitë e këtij vendimi përkatës, si dhe të merren masa e të punohet sipas strukturave të miratuara.

Brenda datës 31.03.2016

5. Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, saktësinë, vërtetësinë dhe plotësinë dhe respektimin e afateve për hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.

Gjetje nga auditimi

-Shoqëria nuk ka mbajtur një regjistër kontabël të aktiveve që zotëron lidhur me saktësimin e vlerës në kontabilitet, në përputhje me formatin ligjor, por i identifikon ato vetëm me emërtimin dhe vlerën përkatëse të tyre, në kundërshtim me pikën 30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Shoqëria nuk ka paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2014, detyrimet e pashlyera për kreditë e Projektit “Mbrotja e Liqenit të Ohrit” në vlerën **959,540.14 EUR**, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardi Kombëtar Kontabël “*SKK 1 - Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*” (Trajtuar më hollësisht në faqet 32-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe sektori i financës, të merren masat për paraqitjen në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor, të detyrimeve që rrjedhin nga kredia e Projektit “Mbrotja e Liqenit të Ohrit”, si dhe saktësimin e vlerës së aktiveve pas inventarizimit vjetor.

Brenda datës 31.03.2016

6. Mbi përlogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Gjetje nga auditimi

-Janë kryer pagesa në vlerat 159,552 lekë dhe 57,565 lekë, gjobë për sigurime shoqërore dhe tatim mbi të ardhurat personale. Vlera **217,117 lekë përbën efekt financiar negativ**, për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec.

-Janë kryer pagesa në vlerat 76,326 lekë, 51,172 lekë dhe 36,311 lekë, gjobë për TVSH (viti 2008), TVSH (viti 2010-2012) dhe tatimfitimi (viti 2008). Vlera **163,809 lekë përbën efekt financiar negativ**, për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec.

-Është kryer pagesa në vlerën 20,000 lekë, gjobë për dividendin. Vlera **20,000 lekë përbën efekt financiar negativ**, për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (Trajtuar më hollësisht në faqet 39-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe sektori i financës, të merren masa për planifikimin e saktë të likuiditeteve të nevojshme për pagesat e detyrimeve që sjellin efekte negative në buxhetin e shoqërisë.

Brenda datës 31.03.2016

7. Mbi evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe analizimin e tyre nga organet drejtuese.

Gjetje nga auditimi

-Ka ndryshime midis të dhënave të sektorëve të financës dhe shitjes për debitorët, në vlerën 53,195,885.3 lekë.

-Nga auditimi i të dhënave të drejtorisë së shitjes, u konstatua se deri më datë 31.08.2015, debia totale ndaj UK Pogradec është në vlerën **264,084,547.17 lekë**. Në total detyrimet përbëjnë 195% të të ardhurave nga shitja të shoqërisë për vitin 2014.

-Nuk konstatohet mënyra e përzgjedhjes së këtyre abonentëve që janë dërguar për ekzekutim të detyrueshëm, kjo për arsye se nga 15 abonentët me detyrimin më të lartë, të cilët të marrë së bashku përbëjnë 15% të detyrimit total (39,636,702.6 lekë nga 264,084,54.17 lekë), vetëm 5 prej tyre janë dërguar për ekzekutim të detyrueshëm, duke favorizuar abonentët debitorë në dëm të interesave të shoqërisë. Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës apo Drejtorit të Përgjithshëm, nuk janë vendosur kritere të qarta (si shuma e detyrimit, koha e detyrimit etj.) për dërgimin për ekzekutim të detyrueshëm të debitorëve.

-Detyrimet që rrjedhin nga kredia për Projektin “Mbrojtja e Liqenit të Ohrit”, janë në vlerën 99,577.68 EUR për vitin 2015. Po kështu, shoqëria rezulton kreditore për detyrimet e pashlyera që lidhen me këtë kredi deri më 31.12.2014, në vlerën **959,540.14 EUR**, e përbërë nga 820,257.65 EUR principal, 125,017.57 EUR interes, 67.52 EUR komision angazhimi dhe 14,197.40 EUR kamat-vonesa (*Trajtuar më hollësisht në faqet 41-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të merret në analizë në mënyrë të vazhdueshme situata lidhur me gjendjen debitorë dhe kreditorë, të realizohet një plan konkret masash për të përmirësuar treguesit financiarë të shoqërisë, si dhe të merren masa për përcaktimin e kritereve të qarta në përzgjedhjen e debitorëve për dërgim në përmbarrim për arkëtim të detyrueshëm.

Brenda datës 31.04.2016

8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për menaxhimin e aktiveve materiale, procedurat e ndjekura për inventarizimet, nxjerrjen jashtë përdorimi si dhe asgjësimin e tyre.

Gjetje nga auditimi

Procesi i inventarizimit nuk kryhet i plotë, pasi ai realizohet vetëm për inventarin ekonomik dhe jo për mjetet kryesore të shoqërisë, ndërsa procesi i vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të shoqërisë nuk kryhet në përputhje me kuadrin rregullator përkatës, por ai ndërmerret me iniciativë të personave të pa autorizuar, në kundërshtim me pikat 95 dhe 96 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Ligjin nr. 9228,

datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, pika 1 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 42-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe sektori i financës, të merren masa për krijimin e regjistrit kontabël të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, kryerjen e inventarizimeve të plota vjetore me qëllim evidentimin e saktë të aktiveve, si dhe të merren masa për kryerjen e plotë të procesit të inventarizimit, nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimit të aktiveve të shoqërisë, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda datës 31.01.2016 dhe Vazhdimisht

9. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e mallrave, shërbimeve dhe investimeve, si dhe zbatimin e këtyre kontratave.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Hartimi i projekt-zbatimit të sistemit të furnizimit me ujë për fshatrat Guras, Gështenjas dhe Bahçallëk”, Dhjetor 2009, anuluar, me vlerë limit 5,129,970 lekë pa tvsh, dhe në tenderin e zhvilluar me objekt “Hartimi i projekt-zbatimit të sistemit të furnizimit me ujë për fshatrat Guras, Gështenjas dhe Bahçallëk”, Mars 2010, anuluar, me vlerë limit 5,129,970 lekë pa tvsh, krahas kërkesave teknike të projektimit që duhet të plotësojë projekti i kërkuar, në pikën 1 “të dhëna kryesore” janë përcaktuar edhe 2 elementë:

1. Vlera paraprake e çmimit për hartimin e projektit 5,129,970 lekë pa tvsh.
2. Vlera paraprake e ndërtimit të objektit 258,568,000 lekë pa tvsh.

Vlera e mësipërme (pika 1), është përcaktuar në kundërshtim me VKM Nr. 1, Datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 3, gërma ç, e cila përcakton se: “Preventivi i koston bazohet në vlerësimin që autoriteti kontraktor u bën burimeve, që i nevojiten për të përmbushur detyrën: kostoja për stafin, mbështetja logjistike dhe inputi fizik. Kostot duhet të ndahen në dy kategori kryesore: tarifat (ose shpërblimi) dhe rimbursimet...”.

-Autoriteti kontraktor SHA Ujësjiellës Kanalizime Pogradec, nuk e ka përdorur në asnjë rast projekt-zbatimin e sistemit të furnizimit me ujë për fshatrat Guras, Gështenjas dhe Bahçallëk, të prokuruar në përfundim të kësaj procedure prokurimi. Në zbatim të Ligjit nr. 10411, datë 07.04.2011 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ujësjiellës Kanalizime, Pogradec, si agjenci e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet Pogradec III”, **ky projekt-zbatim është ribërë nga SHA Ujësjiellës Pogradec**, si dhe nuk është marrë asnjë masë për përdorimin e këtij projekt-zbatimi në Projektin “Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet Pogradec III”. Edhe pse marrëveshja është miratuar pas kryerjes së këtij shërbimi, përfaqësuesit e shoqërisë UK Pogradec ishin në dijeni të plotë të Projektit “Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet Pogradec III”, vërtetuar kjo dhe nga takimi i datave 30 qershor– 6 korrik 2009, midis përfaqësuesve të delegacionit të KfW dhe përfaqësuesve të UK Pogradec. Për sa më sipër, **vlera 6,098,728 lekë**, që përbën vlerën e plotë të kontratës me tvsh, **përbën efekt financiar negativ** për shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pajisje elektrike fuqie për nevojat e SHA”, me vlerë 14,427,072 lekë me tvsh, KVO ka shkelur parimin e barazisë në vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, nga skualifikimi i padrejtë i ofertës së operatorit ekonomik

me vlerë më të ulët (.....SHPK), ofertë e cila është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe duke përdorur argumentim të ndryshëm në zbardhjen e Raportit të Vlerësimit drejtuar titullarit të autoritetit kontraktor, ndryshe nga sa është deklaruar në vlerësimin elektronik. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 2, 46, 53 dhe 55. Për pasojë **vlera 3,269,067.60 lekë, përbën efekt financiar negativ** për UK Pogradec.

-Në 14 raste, autoriteti kontraktor nuk ka analizuar shkaqet e anulimit të procedurës së parë, përpara nisjes së procedurës së re, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VII, pika 1, gërma b.

-Në 9 raste, studimi i vlerës së kontratës është llogaritur në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu II, pika 2/ç.

-Në 5 raste, në procedurat e zhvilluara me objekt “Blerje Karburanti” për periudhën objekt auditimi, në DST e hartuara nga njësia e prokurimit, nuk janë përcaktuar specifikimet e karburantit, si dhe nuk është kërkuar fletë-analiza përkatëse ku të ishin përcaktuar të dhënat e karburantit si densiteti, etj.

-Në 4 raste, nuk konstatohet mënyra e komunikimit me operatorët ekonomikë ofertues, pasi dokumentet e tyre rezultonte të ishin dorëzuar dorazi, në kundërshtim Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 22, pika 1.

-Në 27 raste dosja e tenderit nuk ishte e protokolluar arkivuar, në 15 raste mungonte inventari i dosjes, në 1 rast mungonte formulari i njoftimit të anulimit të procedurës dhe në 13 raste mungonte procesverbali i hapjes së ofertave.

-Në 27 raste titullari i autoritetit kontraktor nuk ka ngritur grup pune për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe në 5 raste nuk konstatohet autorësia e hartimit të tyre, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 2, gërma a.

-Në 5 raste, nuk konstatohen deklaratat e konfliktit të interesit për anëtarët e KVO dhe njësisë së prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 1, gërma b.

-Në 4 raste, formulari i njoftimit të anulimit të procedurës, është dërguar para miratimit të anulimit të procedurës nga titullari i AK, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, pika 4 gërma h.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje matësa uji për nevojat e SHA”, tetor 2010, anuluar, në skualifikimin e operatorëve ekonomikë ofertues, si në faqen online të APP dhe në vendimin si dhe raportin përmbledhës drejtuar titullarit të autoritetit kontraktor, KVO është shprehur vetëm “*Mosplotësim të kriterëve të përcaktuara në DST*” dhe “*Mungesa në dokumentacion*”, por pa përcaktuar se çfarë dokumentacioni mungonte dhe se cilat kriterë nuk plotësonin këta operatorë, si dhe nuk konstatohet procesverbali i marrjes në dorëzim të mostrave nga OE “.....” SHA, edhe pse ky operator është kualifikuar për këtë kriter. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53, pika 5.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje matësa uji për nevojat e SHA”, tetor 2011, Urdhri i prokurimit nuk përmban vlerën e përlllogaritur të kontratës (fondin limit), në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 1, gërma c.

- Në 9 raste, formulari i njoftimit të fituesit, është dërguar para miratimit të klasifikimit përfundimtar (Raportit të Vlerësimit) nga titullari i autoritetit kontraktor, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu I, pika 4 germa h.
- Në 7 raste, kontrata e lidhur me operatorët ekonomikë të shpallur fitues, është nënshkruar para miratimit të raportit përmbledhës nga titullari i autoritetit kontraktor, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu I, pika 4 germa h.
- Në 4 raste, mallrat e sjella janë marrë në dorëzim nga punonjës të shoqërisë, pa u ngarkuar nga titullari i autoritetit kontraktor për marrjen në dorëzim të tyre, ndërsa në 8 raste, është kryer pagesa për mallrat apo shërbimet e prokuruar, pa u marrë më parë në dorëzim, për arsye se nuk është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim nga titullari i autoritetit kontraktor, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 42-50.
- Në 2 raste, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për përdorimin e procedurës “Negocim pa shpallje paraprake të kontratës”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33, pika 2, germa c, si dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu IV, pika 5, germa a.
- Në 7 raste, kryetari i komisionit të vlerësimit nuk është përzgjedhur ndërmjet zyrtarëve më të lartë drejtues të shoqërisë, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 2, germa c.
- Në 3 raste, janë përcaktuar si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave, punonjës të cilët kanë marrë pjesë në hartimin e specifikimeve teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 2, germa c.
- Në 3 raste, vlerësimi i kryer nga komisioni i vlerësimit të ofertave është kryer më vonë se limiti ligjor prej 20 ditësh, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 4, germa c.
- Në 4 raste, operatori ekonomik i shpallur fitues, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në DST, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 55, pika 1.
- Në 1 rast është zhvilluar tender konsulence dhe jo konkurs projektimi, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VI, pika 4, germa a
- Në 1 rast anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave nuk përmbushin kriteret ligjore, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VI, pika 4, germa e.
- Në 1 rast njësia e prokurimit e përcaktuar me urdhrin e prokurimit pa numër protokoll, datë 21.12.2009, është e ndryshme nga njësia e prokurimit që rezulton në sistemin elektronik të APP`së.
- Në 1 rast komisioni i vlerësimit të ofertave, i përcaktuar në urdhrin e prokurimit pa numër protokoll, datë 24.12.2009, është e ndryshme nga komisioni i vlerësimit të ofertave që rezulton në sistemin elektronik të APP`së.
- Në 1 rast KVO në vlerësimin e saj, ka skualifikuar një operator ekonomik, me argumentimin se nuk ka inxhinier mekanik dhe inxhinier Gjeodet, por nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur

elektronikisht nga ky OE, konstatohet se i ka këto inxhinierë të pajisur me licencat përkatëse, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, pika 1.

-Në 1 rast, kontrata e nënshkruar midis palëve, nuk përmban shtojcat e përcaktuara në DST, si dhe nuk është sipas formatit të miratuar nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 58.

-Në 3 raste, nuk konstatohet publikimi në buletin e APP për procedurën e prokurimit të zhvilluar, çka nënkupton se shoqëria nuk ka zhvilluar procedura prokurimi sipas Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 4 “Fusha e zbatimit” dhe neni 38, pika 3.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Karburanti”, Maj 2011, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë “.....” SHPK dhe “.....” SHPK, nuk kanë sjellë asnjëri formularin e sigurimit të ofertës, e për pasojë ofertat e tyre nuk duheshin pranuar, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 2, gërma e.

-Në 3 raste, në DST e miratuara është hequr pika e “Kritereve të veçanta të kualifikimit”, ndërsa në 2 raste është hequr pika e “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 3, gërma b “Kontratat e mallrave”.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Karburanti”, Maj 2011, nuk konstatohet formulari i sigurimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 2, gërma ë.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Karburanti”, Dhjetor 2014, me vlerë 4,675,320 lekë pa tvsh, u konstatua se sasia e karburantit që do prokurohet nuk është e përcaktuar, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 3, gërma b.

-Në të gjitha rastet, për zbatimin e kontratave të rojeve nga titullari i AK nuk është ngritur grup për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42.

-Në një rast nuk konstatohet botimi i njoftimit të kontratës në buletin e APP, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu I, pika 3, gërma ë.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pajisje elektrike fuqie për nevojat e SHA”, Nëntor 2011, me vlerë 14,427,072 lekë me tvsh, një pajisje (inverter) kishte pësuar defekt. Ky dëmtim i inverterit rezulton të jetë brenda periudhës së garancisë së pajisjes së ofruar nga kontraktori (garancia 5 vite). Deri më datë 13.11.2015, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet të jetë lajmëruar kontraktori “.....” SHPK për defektin e dhënë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 47-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nisur nga mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit, nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të vlerësohen kapacitetet në prokurimin e fondeve publike dhe të planifikohen trajnime të vazhdueshme për të rritur nivelin profesional të punonjësve që merren me prokurimet, me synim rritjen e efektivitetit në prokurimet publike.

Vazhdimisht

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe sektori juridik, të merren masa për lajmërimin e operatorit ekonomik “.....” SHPK, për defektin e dhënë nga inverteri, si dhe të merren masa për zëvendësimin e kësaj pajisjeje nga kjo shoqëri, e në rast të kundërt të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës së inverterit nga kjo shoqëri.

Brenda datës 31.01.2016

Këshilli Mbikqyrës, të analizojë efektin financiar negativ në vlerën **3,269,067.60 lekë**, të shkaktuar nga skualifikimi i padrejtë i ofertës së operatorit ekonomik me vlerë më të ulët në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pajisje elektrike fuqie për nevojat e SHA”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës.

Brenda datës 31.01.2016

10. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për prokurimet me vlerë të vogël.

Gjetje nga auditimi

Në 3 raste për periudhën 2013-2015, janë kryer procedura blerje me vlerë të vogël jo me sistemin elektronik të APP-së, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VI, pika 2, Udhëzimin e APP nr. 5, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 118-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të merren masa që procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”, të bëhen të argumentuara dhe sipas nevojave reale të shoqërisë, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Brenda datës 31.01.2016 dhe Vazhdimisht

11. Mbi auditimin me zgjedhje të shpenzimeve të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative, karburante, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, penalitete, gjoba etj.

Gjetje nga auditimi

-Nga auditimi në lidhje konsumin e karburantit për periudhën 01.07.2009-31.08.2015, u konstatua se fletë-udhëtimet nuk janë mbajtur saktë për çdo mjet përkatës, si dhe forma se si janë mbajtur këto fletë-udhëtime (evidencë përmbledhëse), lë shteg për abuzim. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, pika 36.

-Nga auditimi u konstatua se për sasinë prej 13,869 litra me vlerë **2,155,165 lekë**, për periudhën 01.07.2009-31.08.2015, kartelat e mbajtura për konsumin e karburantit nga mjetet që punojnë me orë punë (kur nuk ka energji elektrike), nuk janë plotësuar në mënyrë të rregullt, për arsye se mungojnë evidencat në lidhje me monitorimin e tyre (oraret e ndezjes dhe fikjes së tyre). Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin e vlerave materiale e monetare” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III “*Regjistri i aktiveve dhe*

dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36. Për pasojë vlera **2,155,165 lekë përbën efekt financiar negativ** për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec.

-Nga auditimi në lidhje me analizën e shpenzimeve të mjeteve të transportit, u konstatua se dalje nga magazina për karburant ishte bërë dhe për Përgjegjësin e Sektorit të Brendshëm dhe Financës, në sasinë 7,380 litra dhe me vlerë **1,211,782 lekë**, për periudhën 01.07.2009-31.08.2015, ku nuk kishte shkresë apo urdhër të brendshëm nga Titullari, që ky person duhet të kishte makinë në dispozicion dhe të tërheqë karburant për makinën e tij, në kundërshtim me Ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin e vlerave materiale e monetare” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36. Për pasojë vlera **1,211,782 lekë, përbën efekt financiar negativ** për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 120-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe sektori i financës, të plotësohet dokumentacioni i munguar në lidhje me të gjithë konsumin e verifikuar të karburantit gjatë periudhës objekt auditimi, duke rritur kërkesat për një sistem më të saktë monitorimi dhe kontrolli, lidhur me këtë shpenzim.

Brenda datës 31.01.2016 dhe Vazhdimisht

12. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Gjetje nga auditimi

Menaxhimi financiar, nuk ka funksionuar në shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec. Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë e punonjësit e saj, e për pasojë nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të shoqërisë, si dhe drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 125-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë të merren masa për forcimin e rregullave, kontrolleve dhe dokumentacionit të pagesave të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës, si dhe të merren masa për trajnimin e stafit edhe për aspekte të menaxhimit financiar.

Brenda datës 31.03.2016 dhe Vazhdimisht

13. Mbi Zbatimin e tarifave në lidhjen e kontratave të reja me ujësjetllësin.

Gjetje nga auditimi

Në periudhën Dhjetor 2009 – Gusht 2015, për 1,757 abonentë detyrimi i tarifave për lidhjet e reja, është mbledhur pa përfshirë detyrimin e vlerës së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) në vlerën 4,181,908 lekë, duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 11.07.2006, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 26, datë 18.12.2009 “*Miratim tarife për lidhjet në banesa private*”, Ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 9 dhe Ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e

Shqipërisë”, neni 11 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, sektori i shitjes dhe sektori i financës, të merren masa për zbatimin e Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 11.07.2006, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 26, datë 18.12.2009, mbi tarifatat për lidhjet e reja që do aplikohen në të ardhmen, konform Ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, duke eliminuar procedurat e shmangies nga pagesat e detyrimit të TVSH.

Brenda datës 31.03.2016 dhe Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi

Me Urdhrin e drejtorit të përgjithshëm nr. 44, datë 19.11.2013, ndërpriten marrëdhëniet e punës për si drejtor i departamentit teknik. Në të njëjtin urdhër drejtori i përgjithshëm ka vendosur vazhdimin në detyrë si drejtues teknik për shkak të liçencës së UK Pogradec. Nga auditimi i listë-prezencat mujorë të periudhës dhjetor 2013-korrik 2014, megjithëse nuk është paraqitur asnjë ditë në punë, është paguar rregullisht për këtë periudhë në vlerën **112,910 lekë**, vlerë e cila **përbën dëm ekonomik** për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **112,910 lekë** nga, për pagat e përfituara pa u paraqitur në punë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi

Nën/Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës ka munguar për 15 muaj rradhazi në mbledhjet e Këshillit (mars 2014 –maj 2015), ndërsa anëtari i Këshillit Mbikëqyrës ka munguar për 14 muaj rradhazi (prill 2014 –maj 2015) në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 të Ministrisë të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime” dhe statusin e shoqërisë, neni 19, pika 5. Për pasojë shpërblimi i përfituar nga për këtë periudhë (16,020 x 15 muaj) në vlerën **240,300 lekë**, si dhe shpërblimi i përfituar nga gjatë kësaj periudhe (16,020 x 14 muaj) në vlerën **224,280 lekë**, përbëjnë **dëm ekonomik** për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqen 22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **464,580 lekë**, nga në vlerën **240,300 lekë** dhe nga në vlerën **224,280 lekë**, për përfitimin e padrejtë të shpërblimit pa marrë pjesë për më shumë se 6 muaj rradhazi në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi

Nga verifikimi i listë-pagesës në lidhje me shpërblimin e muajit Dhjetor 2012, konstatohet se është paguar shpërblimi për 3 punonjës në vlerën **49,413 lekë**, edhe pse këta persona nuk janë më në marrëdhënie pune me Shoqërinë, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për shoqërinë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 30-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **49,413 lekë**, nga në vlerën **16,853 lekë**, në vlerën **18,726 lekë** dhe në vlerën **13,833 lekë**, për shpërblimin e përfituar në vitin 2012, pas shkëputjes së marrëdhënieve të punës.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi

Me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë nr. 18, datë 13.06.2011, vendoset dhënia e shpërblimit me 1.5 paga mujore në vlerën 193,380 lekë, për me detyrë koordinator i projekteve pranë KFW, i cili nuk është punonjës i shoqërisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet miratimi i Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me këtë vendim, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6. Për sa më sipër, **vlera 193,380 lekë përbën dëm ekonomik** për shoqërinë (*Trajtuar më hollësisht në faqen 31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **193,380 lekë**, nga për shpërblimin e përfituar në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi

Me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë nr. 19, datë 28.06.2011, vendoset dhënia e shpërblimit në vlerën **22,500 lekë** (gjysma e pagës mujore), për me detyrë menaxhere e operimit teknologjik. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet miratimi i Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me këtë vendim, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6. Për sa më sipër, **vlera 22,500 lekë përbën dëm ekonomik** për shoqërinë (*Trajtuar më hollësisht në faqen 31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **22,500 lekë**, nga për shpërblimin e përfituar në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi

Me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë nr. 20, datë 28.06.2011, vendoset dhënia e shpërblimit në vlerën **54,000 lekë** (në masën e një page mujore) për me detyrë drejtor i departamentit teknik dhe në vlerën **54,000 lekë** (në masën e një page mujore) për me detyrë koordinatorë e projekteve në UK Pogradec. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet miratimi i Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me këtë vendim, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6. Për sa më sipër, **vlera 108,000 lekë përbën dëm ekonomik** për shoqërinë (*Trajtuar më hollësisht në faqen 32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **108,000 lekë**, nga në vlerën **54,000 lekë** dhe në vlerën **54,000 lekë**, për shpërblimin e përfituar në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec, në zhvillimin e procedurës së prokurimit objekt “Blerje matësa uji për nevojat e SHA”, nuk ka marrë parasysh kërkesat e VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjiellës Kanalizimeve SHA”, pika 2.7.3, e cila përcakton se: “Ujëmatësit dhe saraçineskat e instaluara në objekte janë në pronësi të pronarit të objektit/apartamentit, i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre”, si dhe pika 2.8.5, e cila përcakton se: “Lidhja e çdo lloj pajisjeje konsumi të sistemit të brendshëm në mjedisin privat të konsumatorit bëhet me shpenzimet e vetë konsumatorit”, miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve nr. 13, datë 11.06.2010 “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjiellës Kanalizimeve SHA Pogradec”. UK Pogradec nuk i ka faturuar abonentëve të saj, shpenzimet e kryera për blerjen dhe instalimin e matësive, në kundërshtim me dispozitën e sipërpërmendur. Për sa më sipër, **vlera 1,818,740 lekë** (që përbën vlerën e plotë të kontratës përfshirë TVSH), **përbën dëm ekonomik**, për llogari të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, **të analizohet vlera 1,818,740 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me blerjen e 1030 copë matës uji, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA Pogradec dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pajisje elektrike fuqie për nevojat e SHA”, me vlerë 14,427,072 lekë me tvsh, mallrat e sjella me anë të faturës tatimore nr. 32, datë 27.06.2012, me vlerë 6,092,220 lekë më tvsh, janë sjellë 62 ditë kalendarike me vonesë, e për pasojë UK Pogradec duhej të llogariste likuidimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar, në vlerën 1,510,870.56 lekë (6,092,220 lekë * 62 ditë * 4/1000). Veprime në kundërshtim me kontratën e nënshkruar

midis palëve pa numër protokolli, datë 27.01.2012, Shtojca 13, neni 24.1, gërma a. Për pasojë **vlera 1,510,870.56 lekë, përbën dëm ekonomik** për llogari të UK Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 59-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **1,510,870.56 lekë** nga operatori ekonomik “.....” SHPK, për dëmet e likuidueshme për vonesën në dorëzimin e mallrave në zbatim të kontratës pa numër protokolli të datës 27.01.2012, të nënshkruar midis palëve.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje elektropompë uji për nevojat e shoqërisë”, me vlerë 1,200,000 lekë me tvsh, mallrat e sjella me anë të faturës tatimore nr. 15, datë 31.08.2011, me vlerë 1,200,000 lekë më tvsh, janë sjellë 17 ditë kalendarike me vonesë, e për pasojë UK Pogradec duhej të llogariste likuidimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar, në vlerën 81,600 lekë (1,200,000 lekë * 17 ditë * 4/1000). Veprime në kundërshtim me kontratën e nënshkruar midis palëve pa numër protokolli, datë 27.01.2012, Shtojca 13, neni 24.1, gërma a. Për pasojë **vlera 81,600 lekë, përbën dëm ekonomik** për llogari të UK Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 66-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **81,600 lekë** nga operatori ekonomik “.....” SHPK, për dëmet e likuidueshme për vonesën në dorëzimin e mallrave në zbatim të kontratës pa numër protokolli të datës 25.07.2011, të nënshkruar midis palëve.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Hartimi i projekt-zbatimit të sistemit të furnizimit me ujë për fshatrat Guras, Gështenjas dhe Bahçallëk”, projekt-zbatimi i sjellë me anë të faturës tatimore nr. 6, datë 27.09.2010, me vlerë 6,098,728 lekë me tvsh, është sjellë 10 ditë kalendarike me vonesë, e për pasojë UK Pogradec duhej të llogariste likuidimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar, në vlerën 243,949 lekë (6,098,728 lekë * 10 ditë * 4/1000). Veprime në kundërshtim me kontratën e nënshkruar midis palëve pa numër protokolli, datë 12.07.2010, Shtojca 8, neni 20.1, gërma a. Për pasojë **vlera 243,949 lekë, përbën dëm ekonomik** për llogari të UK Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 72-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **243,949 lekë** nga operatori ekonomik “.....” SHPK, për dëmet e likuidueshme për vonesën në dorëzimin e projekt-zbatimit në zbatim të kontratës pa numër protokolli të datës 12.07.2010, të nënshkruar midis palëve.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Karburanti”, me vlerë 3,240,000 lekë pa tvsh, sipas kontratës së lidhur midis palëve dhe sipas ofertës së dhënë, operatori ekonomik SHPK, duhej ta faturonte karburantin (si naftën dhe benzinën) e sjellë me çmimin 108 lekë/Lt, kjo për arsye se ka ofertuar vetëm në vlerë kontratë dhe jo me marzh fitimi. Por nga verifikimi i faturave tatimore, konstatohet se faturimi është kryer me çmime të ndryshme nga çmimi i kontraktuar, duke faturuar më tepër vlerën 252,811 lekë. Për pasojë, **vlera 252,811 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 77-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i **vlerës 252,811 lekë** nga operatori ekonomik SHPK, për faturimin e kryer në kundërshtim me kontratën pa numër protokollit të datës 19.02.2010, të nënshkruar midis palëve.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi

Me datë 04.04.2011, titullari i autoritetit kontraktor ka lidhur shtesën e kontratës pa numër protokollit, për furnizimin me sasi shtesë 5,200 lt naftë dhe 700 lt benzinë. Sipas kontratës së lidhur midis palëve dhe sipas ofertës së dhënë, operatori ekonomik SHPK, duhej ta faturonte karburantin (si naftën dhe benzinën) e sjellë me çmimin 133 lekë/Lt, kjo për arsye se ka ofertuar vetëm në vlerë kontratë dhe jo me marzh fitimi. Por nga verifikimi i faturave tatimore, konstatohet se në faturën tatimore nr. 39, datë 25.04.2011, faturimi është kryer me çmimin 133.33 lekë/Lt, si dhe në faturën tatimore nr. 54, datë 24.05.2011, faturimi është kryer me çmimin 141.66 lekë/Lt, ndryshe nga çmimi i kontraktuar. Nga ky veprim SHPK ka **faturuar më tepër vlerën 26,829 lekë**. Për pasojë, **vlera 26,829 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 77-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i **vlerës 26,829 lekë** nga operatori ekonomik SHPK, për faturimin e kryer në kundërshtim me kontratën pa numër protokollit të datës 04.04.2011, të nënshkruar midis palëve.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi

Janë kryer pagesa në vlerën **120,809 lekë**, për servisën e makinës tip Toyota në Greqi, pa dokumentacion vërtetues, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 01.02.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, pika 6. Për pasojë vlera **120,809 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqen 121, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 120,809 lekë**, nga me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015, për shpenzimet e servisit të makinës të kryer në Greqi, pa dokumentacion vërtetues në kundërshtim me udhëzimin nr. 1, datë 01.02.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi

Janë kryer pagesa në vlerën **420,695 lekë**, për blerje matësa uji, në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës Kanalizimeve SHA”, pika 2.7.3, e cila përcakton se: “Ujëmatësit dhe saraçineskat e instaluara në objekte janë në pronësi të pronarit të objektit/apartamentit, i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre”, si dhe pika 2.8.5, e cila përcakton se: “Lidhja e çdo lloj pajisjeje konsumi të sistemit të brendshëm në mjedisin privat të konsumatorit bëhet me shpenzimet e vetë konsumatorit”, miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve nr. 13, datë 11.06.2010 “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës Kanalizimeve SHA Pogradec”. UK Pogradec nuk i ka faturuar abonentëve të saj, shpenzimet e kryera për blerjen dhe instalimin e matësive, në kundërshtim me dispozitën e sipërpërmendur. Për pasojë vlera **420,695 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqen 122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të analizohet vlera **420,695 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me blerjen e 177 copë matës uji, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Pogradec dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi

Janë kryer pagesa në vlerën **156,000 lekë**, për riparim transformatori, pa dokumentacion vërtetues e shoqërues, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Për pasojë vlera **156,000 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqen 123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 156,000 lekë**, nga me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015 dhe me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Brendshëm dhe Financës për periudhën objekt auditimi, për riparim transformatori, pa dokumentacion vërtetues e shoqërues, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

16. Gjetje nga auditimi

Janë kryer pagesa në vlerën **162,000 lekë**, për blerje sharra inoksi, pa dokumentacion vërtetues e shoqërues, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Për pasojë vlera **162,000 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqen 123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 162,000 lekë**, nga me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015 dhe me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Brendshëm dhe Financës për periudhën objekt auditimi, për blerje sharra inoksi, pa dokumentacion vërtetues e shoqërues, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi

Janë kryer pagesa në vlerën **30,000 lekë**, paradhënie për shërbim në Gjermani për dhe, të pa justifikuar me dokumentacion vërtetues, në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 11, ku përcaktohet se: “.....shpenzimet e transportit, të fjetjes dhe pagesat e tjera, në të gjitha rastet, njihen dhe paguhen sipas dokumentit përkatës justifikues (faturë, bileta etj.)”. Për pasojë vlera **30,000 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 30,000 lekë**, nga me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015 dhe me detyrë Menaxher IT për periudhën objekt auditimi, për paradhënie për shërbim në Gjermani, të pa justifikuar me dokumentacion vërtetues, në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi

Janë kryer pagesa në vlerën **515,000 lekë**, për shërbim kontrata për mirëmbajtjen e sistemit të faturimit, për të cilën nuk u paraqit dokumentacioni i nevojshëm si dhe aktmarrëveshja me kompaninë, që ka kryer shërbimin, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Për pasojë vlera **515,000 lekë përbën**

dëm ekonomik për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 123-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 515,000 lekë**, nga me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015 dhe me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Brendshëm dhe Financës për periudhën objekt auditimi, për mirëmbajtjen e sistemit të faturimit, për të cilën nuk u paraqit dokumentacioni i nevojshëm si dhe aktmarrëveshja me kompaninë, që ka kryer shërbimin, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi në lidhje me analizën e shpenzimeve të mjeteve të transportit, u konstatua se është bërë dalje nga magazina karburant në sasinë 620 litra dhe me vlerë **91,666 lekë**, për, të pa justifikuar me dokumentacion vërtetues (fletë-udhëtime), në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36. Për pasojë vlera **91,666 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqen 125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 91,666 lekë**, nga me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015, për karburantin e tërhequr në muajin Qershor 2013, në kundërshtim me Ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin e vlerave materiale e monetare” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi në lidhje me analizën e shpenzimeve të mjeteve të transportit, u konstatua se është bërë dalje nga magazina në muajin tetor 2014, karburant në sasinë 500 litra dhe me vlerë **91,100 lekë**, nga për makinat e reja teknologjike, të cilat në fakt janë bërë hyrje me datë 25.11.2014 me fletë hyrje nr. 73. Nuk ka një procesverbal që vërteton vënien në punë të këtyre makinave teknologjike dhe përdorimin e kësaj sasive karburanti në km dhe në litra/orë pune, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36. Për pasojë vlera **91,100 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqet 125-126, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 91,100 lekë**, nga me detyrë Përgjegjës i sektorit mekanik dhe inxhinier për prodhimin e ujit, për periudhën korrik 2009 – gusht 2015, për karburantin e tërhequr në muajin Tetor 2014, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi në lidhje me analizën e shpenzimeve të mjeteve të transportit, u konstatua se është bërë dalje nga magazina karburant në sasinë 2,430 litra dhe me vlerë **409,116 lekë**, nga për periudhën Janar 2014 – Gusht 2015, të pa justifikuar me dokumentacion vërtetues (fletë-udhëtime), në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III “*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*”, pika 36. Për pasojë vlera **409,116 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec (*Trajtuar më hollësisht në faqen 126, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 409,116 lekë**, nga me detyrë shofer i drejtorit të përgjithshëm, për karburantin e tërhequr të pa justifikuar me dokumentacion vërtetues (fletë-udhëtime) në periudhën Janar 2014 – Gusht 2015, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, dhe kontratës kolektive të punës nr. 114, datë 22.04.2015, neni 23, si dhe kontratave individuale neni 13, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Zgjidhje të kontratës së punësimit”

ose

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për:

1. me detyrë Përgjegjës i sektorit mekanik dhe inxhinier për prodhimin e ujit, për periudhën korrik 2009 – gusht 2015.

-Për përlllogaritjen e vlerës së kontratës në 3 raste, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu II, pika 2/c,ç.

-Për kryerjen e kolaudimit në 2 raste, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,592,470.56 lekë.

-Në 2 raste ka kryer procedurën e kolaudimit, pa u autorizuar më parë nga titullari i AK, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Për hartimin e specifikimeve teknike pa u autorizuar më parë nga titullari i AK, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 2, gërma a.

-Nga auditimi u konstatua se për sasinë prej 13,869 litra me vlerë 2,155,165 lekë, për periudhën 01.07.2009-31.08.2015, kartelat e mbajtura për konsumin e karburantit nga mjetet që punojnë me orë punë (kur nuk ka energji elektrike), nuk janë plotësuar në mënyrë të rregullt, për arsye se mungojnë evidencat në lidhje me monitorimin e tyre (oraret e ndezjes dhe fikjes së tyre). Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin e vlerave materiale e monetare” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36. Për pasojë vlera 2,155,165 lekë përbën efekt financiar negativ për shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje matësa uji për nevojat e SHA”, tetor 2010, anuluar, në skualifikimin e operatorëve ekonomikë ofertues, si në faqen online të APP dhe në vendimin si dhe raportin përmbledhës drejtuar titullarit të autoritetit kontraktor, KVO është shprehur vetëm “*Mosplotësim të kriterëve të përcaktuara në DST*” dhe “*Mungesa në dokumentacion*”, por pa përcaktuar se çfarë dokumentacioni mungonte dhe se cilat kriterë nuk plotësonin këta operatorë, si dhe nuk konstatohet procesverbali i marrjes në dorëzim të mostrave nga OE “.....” SHA, edhe pse ky operator është kualifikuar për këtë kriter. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53, pika 5.

-Për shkeljet e konstatuara në procesin e vlerësimit, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pajisje elektrike fuqie për nevojat e SHA”, me vlerë 14,427,072 lekë me tvsh.

2. me detyrë Menaxher i IT për periudhën objekt auditimi.

-Për kryerjen e kolaudimit 3 muaj para sjelljes së materialeve fizike nga operatori ekonomik “.....” SHPK, e zhvilluar me objekt “Blerje pajisje elektrike fuqie për nevojat e SHA”, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,510,870.56 lekë.

-Në 3 raste ka kryer procedurën e kolaudimit, pa u autorizuar më parë nga titullari i AK, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje matësa uji për nevojat e SHA”, tetor 2010, anuluar, në skualifikimin e operatorëve ekonomikë ofertues, si në faqen online të APP dhe në vendimin si dhe raportin përmbledhës drejtuar titullarit të autoritetit kontraktor, KVO është shprehur vetëm “*Mosplotësim të kriterëve të përcaktuara në DST*” dhe “*Mungesa në dokumentacion*”, por pa përcaktuar se çfarë dokumentacioni mungonte dhe se cilat kriterë nuk plotësonin këta operatorë, si dhe nuk konstatohet procesverbali i marrjes në dorëzim të mostrave nga OE “.....” SHA, edhe pse ky operator është kualifikuar për këtë kriter. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53, pika 5.

-Për shkeljet e konstatuara në procesin e vlerësimit, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pajisje elektrike fuqie për nevojat e SHA”, me vlerë 14,427,072 lekë me tvsh.

3. me detyrë drejtor i drejtorisë së shërbimit konsumator për periudhën 01.05.2010-25.09.2013.

-Nga shoqëria janë dërguar për arkëtim të detyrueshëm në përmbarrim, vetëm 133 abonentë për vlerën 16,300,846 lekë. Nuk konstatohet mënyra e përzgjedhjes së këtyre abonentëve që janë

dërguar për ekzekutim të detyrueshëm, kjo për arsye se nga 15 abonentët me detyrimin më të lartë, të cilët të marrë së bashku përbëjnë 15% të detyrimit total (39,636,702.6 lekë nga 264,084,54.17 lekë), vetëm 5 prej tyre janë dërguar për ekzekutim të detyrueshëm.

-Nga krahasimi i të dhënave të drejtorisë së shitjes me drejtorinë e financës, konstatohet se deri më datë 31.08.2015, detyrimi sipas drejtorisë së shitjes është në vlerën 264,084,547.17 lekë, ndërsa sipas financës detyrimi është në vlerën 204,687,923.64 lekë. Si konkluzion, ka ndryshime midis të dhënave të sektorëve të ndryshëm si financa dhe shitja, në vlerën 53,195,885.3 lekë (pa përfshirë kamatëvonesën).

-Nga auditimi u konstatua se për sasinë prej 13,869 litra me vlerë 2,155,165 lekë, për periudhën 01.07.2009-31.08.2015, kartelat e mbajtura për konsumin e karburantit nga mjetet që punojnë me orë punë (kur nuk ka energji elektrike), nuk janë plotësuar në mënyrë të rregullt, për arsye se mungojnë evidencat në lidhje me monitorimin e tyre (oraret e ndezjes dhe fikjes së tyre). Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin e vlerave materiale e monetare” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36. Për pasojë vlera 2,155,165 lekë përbën efekt financiar negativ për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime SHA Pogradec.

-Në 1,757 raste për periudhën Dhjetor 2009 – Gusht 2015, detyrimi i tarifave për lidhjet e reja, është mbledhur pa përfshirë detyrimin e vlerës së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 11.07.2006, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 26, datë 18.12.2009 “*Miratim tarife për lidhjet në banesa private*”. Për pasojë, **nuk është mbledhur detyrimi i TVSH në vlerën 4,181,908 lekë për 1,757 abonentë**, në kundërshtim me Ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 9 dhe Ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 11.

-Nga auditimit i të dhënave të drejtorisë së shitjes, u konstatua se deri më datë 31.08.2015, debia totale ndaj UK Pogradec është në vlerën **264,084, 547.17 lekë**. Në total detyrimet përbëjnë 195% të të ardhurave nga shitja të shoqërisë për vitin 2014.

4. në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit për periudhën objekt auditimi.

-Në 14 raste, autoriteti kontraktor nuk ka analizuar shkaqet e anulimit të procedurës së parë, përpara nisjes së procedurës së re, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VII, pika 1, gërma b.

-Në 4 raste, nuk konstatohet mënyra e komunikimit me operatorët ekonomikë ofertues, pasi dokumentet e tyre rezultonte të ishin dorëzuar dorazi, në kundërshtim Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 22, pika 1.

-Në 27 raste dosja e tenderit nuk ishte e protokolluar arkivuar, në 15 raste mungonte inventari i dosjes, në 1 rast mungonte formulari i njoftimit të anulimit të procedurës dhe në 13 raste mungonte procesverbali i hapjes së ofertave. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13.

-Në 4 raste, formulari i njoftimit të anulimit të procedurës, është dërguar para miratimit të anulimit të procedurës nga titullari i AK, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, pika 4 gërma h.

-Në 3 raste, në DST e miratuara është hequr pika e “Kritereve të veçanta të kualifikimi”, ndërsa në 2 raste është hequr pika e “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 3, gërma b “Kontratat e mallrave”.

Për personat e përmendur më sipër, Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, sipas shkeljeve ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tyre, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë, mund të aplikojë një nga dy masat e rekomanduara.

Shënim: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, drejtuese, menaxhuese dhe ligjzbatuese, të cilat do të vlerësoheshin me masën disiplinore “Largim nga detyra” në vartësi të përgjegjësisë së konstatuar për:

1. me detyrë drejtor i shoqërisë për periudhën 22.05.2015-14.10.2015, shkarkuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës;
2. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Brendshëm dhe Financës për periudhën objekt auditimi, dalë në pension;
3., në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave për tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pajisje elektrike fuqie për nevojat e SHA”;
4., në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave për tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pajisje elektrike fuqie për nevojat e SHA”;
5. me detyrë Drejtor i Departamentit Teknik për periudhën korrik 2011 – nëntor 2013;

Meqënëse personat e mësipërm nuk janë në marrëdhënie pune, masën e propozuar e konsiderojmë të ezauruar. Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për rezultatet e auditimit të KLSH për këto persona.

D. TË TJERA

Pavarësisht përpjekjeve të përgjegjësit të grupit të auditimit, rezultatet e këtij auditimi vlerësohen dobët nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Alfonc Gabili, Dritan Kore, Redina Karapici dhe Shkëlqim Alushi, më tej u shqyrtua nga k/auditues Yllka Pulashi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj dhe Drejtori i Përgjithshëm Manjola Naço.